



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I.-21-0044-A0001

Në çështjen juridike të:

N R Podujevë, i përfaqësuar nga avokatja Sabrije Jashari rr. "Qamil Hoxha" nr. 4/4- Prishtinë.

Paditësi/ankuesi

Kundër:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit(AKP), Rr. "Agim Ramadani" nr. 23, Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2877, të datës 28 dhjetor 2020, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2877 i datës 28 dhjetor 2020 dhe Vendimi i AL të AKP-së PRN073-0155 i datës 13 mars 2014.**
- 3. Obligohet AKP që paditësit N R t'i bëjë kompensimin e shumës prej 2.454,00 euro në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore tetor 2005 deri në prill 2006, në emër të përfaqësimit shumën prej 104.00 euro, në emër të taksave gjyqësore shumën prej 40 euro dhe në emër të kamatës shumën prej 245.00 euro(10%), në procedurë të likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.**
- 4. Nuk caktohen taksat gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 17 prill 2014 paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJSK me të cilën e kundërshtonte Vendimin e Autoritetit të Likuidimit të NSH-së "Energomontimi", e administruar nga AKP(AL i AKP-së) PRN073-0155 të datës 13 mars 2014. Paditësi kërkoi kompensimin për pagat e pa paguara për periudhën kohore tetor 2005 deri në prill 2006, në shumën prej 2.454,00 euro.

AL i AKP-së, me këtë vendim e kishte refuzuar si të pa vlefshme kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara, me arsyetimin se kjo kërkesë është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar(LPB). Nuk ka asnjë dëshmi që kjo kërkesë të jetë parashtruar para një gjykate apor organi kompetent brenda 3 vitesh nga dita kur pretendohet të ketë lindur detyrimi. Parashtruesi këtë kërkesë për herë të parë e kishte parashtruar para AL të AKP-së më 17 janar 2014, ndërsa ndërmarrja ishte privatizuar më 27 prill 2006 dhe marrdhënia e punës për të gjithë punëtorët ishte ndërprerë në muajin prill 2006 dhe të gjitha kërkesat kreditore është dashur të parashtrohen brenda 3 vitesh në një gjykatë apo organ kompetent.

Ankuesi mendon se AL i AKP-së gabimisht e ka aplikuar nenin 608 të LPB-së, pasi që kjo dispozitë nuk e rregullon çështjen e pagave të pa paguara, por në këtë rast është dashur që të aplikohet neni 36 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 respektivisht nenin 34 të Ligjit 04/L-035 si ligj special.

Ankuesi e quant ë gabuar vendimin për hedhje si të palejueshme të kërkesës së paditësit se kinse është parashkruar. Ai këtë pretendim e mbështet me faktin se më 28 prill 2006 përmes një Njoftimi atij i është ndërprerë marrdhënia e punës. Në këtë njoftim thuhej se, nëse keni ndonjë kërkesë për paga të pa paguara, do të njoftoheni pas inicimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Për këtë arsye, paditësi ka pritur njoftimin për fillimin e likuidimit, andaj efekti i parashtrimin të ankesës duhet të rrjedh, prej datës kur NSH ka shkuar në proces të likuidimit, e jo prej kohës kur punëtorëve ju ka ndërprerë marrdhënia e punës, e që është paraparë me dispozitat ligjore në fuqi.

Paditësi konsideron se nuk bëhet fjalë për parshkrim të kërkesës sepse, ai këtë kërkesë nuk ka pasur mundësi ta parashtrroj para se të fillojë procesi i likuidimit

Paditësi ka propozuar që të aprovohet ankesa dhe të prishet vendimi i kundërshtuar I AL të AKP-së.

Në përgjigjen e saj të datës 24 gusht 2020 AKP i kundërstoi pretendimet ankimore të paditësit si të pa bazuara. Sipas AKP-së AL i AKP-së ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kërkesën e paditësit dhe vendimi i marrë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, Andaj AKP propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së.

Më 28 dhjetor 2020 Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-14-2877 me të cilin ishte refuzuar ankesa e paditësit dhe ishte vërtetuar vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së.

Shkalla e parë e DHPGSK-së kishte konsideruar se kërkesa ishte parashkruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar dhe nenit 137 i LMD-së të vitit 1978. Këto dispozita parashohin afatin e parashkrimit të këtyre kërkesave brenda 3 vitësh. Bazuar në këto dispozita, kërkesa nga ana e paditësit duhej të parashtrohej në ndonjë gjykatë apo organ tjetër kompetent brenda 3 vitesh nga momenti kur pretendohet të ketë lindur detyrimi për komensimin për paga të pa paguara. Kërkesa për kompensimin është parashtruar më 17 janar 2014, ndërsa kërkesa ishte parashkruar në muajin tetor 2008. Barra e të provuarit konform nenit 7 të LPK-së, bie mbi paditësin për të dëshmuar se ky afat është ndërprerë me ndonjë veprim juridik të paditësit.

Më 20 janar 2021 kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë paditësi/ankuesi për shkak të të gjitha arsyeve ankimore. Ankuesi thekson seas AL i AKP-së e as Dhoma e Posaçme nuk i kanë kontestuar faktin se, paditësi ka qenë punëtor i NSH-së dhe faktin e mos pagesës së kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrdhënies së punës. Ankuesi thekson gjithashtu se më 28 prill 2006 ai dhe punëtorët tjerë të NSH-së kishin pranuar Njoftimin nga AKM për ndërprerje të marrdhënies së punës në të cilin ndër të tjera thuhej: "shumat-pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës së punës me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura". Bazuar në këtë njoftim, paditësi i është përmbajtur udhëzimeve të AKM-së dhe kur ka filluar ky proces, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesën e tij dhe nuk bëhet fjalë për parashkrim. Menaxhmnti i NSH-së kishte llogaritur pagat e punëtorëve për tre muajt e fundit dhe ky dokumentacion është përcjell tek AL i AKP-së (Njoftimi i AKM-së, lista e pagave për muajt janar, shkurt dhe mars 2006e fundit dhe librezat e punës, janë bashkangjitur).

Ankuesi pretendon se bazuar në Ligjin e Punës nr. 03/L-212 neni 76 flet për përjashtimet kolektive. Në këtë situatë, punëtorëve u takon dëmshpërblimi, konform nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në, kur punëtorët janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim apo si rrjedhojë e veprimeve të ndërmarrë nga Agjencia. Kjo e drejtë është e garantuar me ligj dhe bazohet në përvojën e punës së punëtorit.

Ankuesi e kundërshton vlerësimin e Shkallës së parë sa i përket fillimit të rrjedhës së parashkrimit, por edhe në tërësi vlerësimin për parashkrimin bazuar në nenin 608 të LPB-së dhe nenit 137 të LMD-së. Sipas ankuesit, ky konstatim është i gabuar, sepse me Njoftimin nga AKM të datës 28 prill 2006, nuk kishte asnjë afatizim në 3 vite, por thuhej “deri në datën e hapjes së likuidimit të NSH-së. Paditësi i referohet presedanit të Kolegjit të Apelit në lëndën AC-I.-17-0238-A0001 në rastin e N S, ku si bazë relevante ishin marrë Njoftimi, lista e pagave, dhe mungesa e parashkrimit. Gjithashtu, paditësi i referohet edhe rastit tjetër të S B në lëndën AC-I.-14-0323-A0001, por edhe raste të tjera konkrete.

Paditësi propozon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet aktgjykimi i ankimuar, apo të detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shumën e pretenduar, kamatën prej 10 për qind sipas nenit 37.3 e Ligjit të AKP-së dhe shkallën prej 8 për qind duke u bazuar në nenin 382.2 të LMD-së prej datës 12 prill 2014 deri në ditën e marrjes së vendimit nga gjykata në shumën që e llogaritë vetë gjykata, si dhe shpenzimet gjyqësore në shumën prej 416 euro dhe 40 euro për taksat gjyqësore.

Më 06 dhjetor 2021 Kolegji i Apelit këtë ankesë e ka dërguar tek AKP për përgjigje. Në përgjigjen e saj të datës 10 dhjetor 2021 AKP i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit si të pa bazuar dhe propozon që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 10.9 të Ligjit nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) dhe nenit 60.2 dhe nenit 64.1 të Shtojcës, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Shkalla e parë e DHPGSK-së me Aktgjykimin e ankimuar kishte marrë duke u bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar dhe nenin 137 të LMD-së të vitit 1978, ku parashihet afati i parashkrimit të këtyre kërkesave brenda 3 vitësh. Bazuar në këto dispozita, kërkesa nga ana e paditësit duhej të parashtrohej në ndonjë gjykatë apo organ tjetër kompetent brenda 3 vitesh nga momenti kur pretendohet të ketë lindur detyrimi. Kërkesa për kompensimin është parashtruar më 06 janar 2014, ndërsa kërkesa ishte parashkruar më 27 prill 2009.

Sipas ankuesit, më 28 prill 2006 ai dhe punëtorët tjerë të NSH-së kishin pranuar Njoftimin nga AKM për ndërprerje të marrëdhënies së punës në të cilin ndër të tjera thuhej: "Shumat-pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës së punës me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura". Bazuar në këtë njoftim, ai i është përmbajtur udhëzimeve të AKM-së dhe kur ka filluar ky proces, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesën e tij dhe nuk bëhet fjalë për parashkrim.

Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësit, aktgjykimin e ankimuar dhe provat në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se ankesa është e bazuar.

Kolegji i Apelit konstaton se ankuesi kërkesën e tij para AL të AKP-së e kishte parashtruar brenda afatit për parashtrimin e kërkesave kreditore tek AL i AKP-së. Ai kishte pretenduar se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 28 prill 2006. Të njëjtat pretendime ankuesi i kishte paraqitur edhe para Shkallës së parë të DHPGJSK-së, por nuk i kishte vërtetuar me prova dhe dëshmi konkrete këto pretendime, andaj Shkalla e parë me të drejtë e kishte refuzuar ankesën si të pa bazuar dhe e kishte vërtetuar vendimin e kundërshtuar të AL të AKP-së. Duke analizuar këtë vendim të AL të AKP-së, por edhe aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së parë, është e qartë këto vendime janë të bazuar në fakte dhe prova konkrete që janë ofruar nga paditësi.

Megjithatë, në fazën e ankesës paditësi ka ofruar njoftimin e dhënë nga AKM me të cilin dëshkohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i privatizimit të NSH-së. Me këtë njoftim AKM kishte marrë përsipër borxhin për pagat eventuale dhe i kishte sugjeruar paditësit se këtë kërkesë duhet ta parashtroj në procesin e likuidimit, kur të filloj ky proces. Ankuesi ka ofruar gjithashtu edhe listat e pagave për muajin janar, shkurt dhe mars të vitit 2006 ku shihet edhe lartësia e pagave të punëtorëve për këtë periudhë.

Duke e respektuar atë që është thënë në Njoftim, paditësi e ka parashtruar kërkesën e tij në afatin e paraparë për dorëzimin e kërkesave kreditore tek AL i AKP-së dhe kishte një pritshmëri të arsyeshme se lidhur me këtë të drejtë do vendosej pozitivisht. Këtë njoftim duhej ta kishte në dispozicion edhe AL i AKP-së. Është e qartë se këto dëshmi provojnë se në këtë rast konkret ishte ndërprerë afati i parashkrimit, sepse me njoftimin e datës 28 prill 2006 ishte pranuar borxhi ndaj paditësit.

Bazuar në nenin 70 të Ligjit të DHPGJSK-së, me qëllim që të arrihet efekti i drejtësisë në këtë rast specifik, Kolegji i Apelit i pranon këto prova në këtë fazë të procedurës si të vlefshme.

Për këto arsye, pasi që AKP nuk e ka kontestuar shumën e pretenduar por ka vendosur vetëm mbi bazën e parashkrimit të kërkesës, Kolegji i Apelit e ndryshon Aktgjykimin e Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2877 të datës 28 dhjetor 2020 dhe Vendimin e AL të AKP-së PRN073-0155 të datës 13 mars 2014, e obligon AKP-në që paditësit Nexhmi Ramadani t'i bëjë kompensimin e shumës prej 2.454,00 euro në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore tetor 2005 deri në prill 2006, në emër të përfaqësimit shumën prej 104.00 euro, në emër të taksave gjyqësore shumën prej 40 euro dhe në emër të kamatës shumën prej 245.00 euro(10%, konform nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së), në procedurë të likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

Taksat gjyqësore

Pasi që tashmë paditësi/ankuesi ka bërë pagesën e taksës gjyqësore në emër të ankesës së parashtruar, ai nuk ngarkohet me taksë gjyqësore shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 13 janar 2022.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues _____

